



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:058201

Datë: 12.11.2019

Numri i dokumentit: 00642660

**P.nr.1002/14**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM –Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues, Hysnije Gashi dhe me praktikanten e kësaj Gjykate Doresa Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit, F.I , për shkak të veprës penale sulmi nga 187 par të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.2539-4/13, te datës 19.09.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 07.11.2019 në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurit F.I me datën 12.11.2019, murr dhe shpalli publikisht këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:F.I** , me vendbanim ne fshatin G..., i lindur me datën ..., ne Ferizaj, nga i ati N...dhe e ëma S..., e vajzërisë A... , i pa martuar, me profesion zdrukthar, i gjendjes së varfër ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJATOR**

Sepse me datë 20.11.2013 , rreth orës 12:00, ne fshatin Greme Komuna Ferizaj, Pas një mosmarrëveshje me babin e tij N... ku i dëmtuari e fton te dyshuarin për te ngrënë bukë, ai i revoltuar perse ia prish gjumin e godet me grushta dhe shqelma ne pjesë te ndryshme te trupit pa pëlqimin e tij.

**- me të cilën ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së**

**Andaj Gjykata në bazë nenit 365 par. 8 dhe neneve 7, 8, 9, 10, 17, 23, 41, 43, 49, 50,51, 52, 73, të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPRK-ës, e**

## **G J Y K O N**

**Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) MUAJ , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /nje / viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër.**

I dëmtuari, N.I nga fshati ..., K.Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej 20€(njëzet euro) në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.2539-4/2013, te datës 19.09.2014, e ka ngarkuar të pandehurin : F.I për veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më datë. 07.11.2019 në të cilin Prokurori i Shtetit, Avdullah Abedini, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që te pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoi sanksion penal sipas ligjit.

I pandehurit, F.I, ne shqyrtimin fillestar , me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së kanë deklaruar se:

E pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, duke shtuar se është i penduar thellë për veprën penale të cilën e ka kryer dhe nga ai moment nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje me babin e tij dhe i premtoi gjykatës se nuk do ti përsërisë vepra të tilla apo te ngjajshme, i propozoj gjykatës që të me shqiptoj ndonjë dënim sa me te butë.

\_ Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes .

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues komfor nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, deri tani nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim te formës se prere , është i moshës se re , premtimin se nuk do të përsërisë veprën penale të tillë apo të ngjashme , gjendjen e tij të dobët ekonomike, në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave te pandehurit i vërtetoi dënim si në dispozitiv te ketij aktgjykimi , në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në propcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari, N.I nga fshati ..., K.Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej 20€(njëzet euro) në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.1002/14 te datës 12.11.2019**

**Praktikante;**  
Doresa Mustafa

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Hysnije Gashi

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.